



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.95/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma Socialdemokrate me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e organizatës Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë BIRN, ndërsa koalicionit NISMA-AKR-PD, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2,500.00 euro, (dy mijë e pesëqind) të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 26.09.2019, me të cilën pretendon se kandidati për deputet Endrit Shala, nga radhët e subjektit politik Nisma, në postimin e tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar një fotografi nga një tubim i fushatës zgjedhore ku shihet së bashku me një fëmijë i mitur i cili mban të veshur një bluzë që bën thirrje për ta votuar kandidatin nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, Endrit Shala. Paraqitësi i ankesës pretendon se me këtë Endrit Shala, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, ka shkelur rregulloren zgjedhore 13/2013 përkatësisht neni 5 pikën 5.2.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2019, subjekti politik Nisma Socialdemokrate, thekson se lidhur me këtë rast nuk ka asnjë shkelje nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e këtij subjekti politik Nisma Socialdemokrate, dhe se kanë qenë të kujdesshëm në fushatë zgjedhore të mbajtur në sallën 1 Tetori, me datën 26.09.2019, për mos përfshirjen e personave, të cilët apostrofohen në nenin 5.2 të rregullave zgjedhore 13/2013, në vazhdim të përgjigjes lidhur me rastin konkret subjekti në fjalë thekson se bëhet fjalë për prezencën e familjarëve për deputet në listën zgjedhore të koalicionit z. Endrit Shala, përkatësisht fëmijës

së tijë, Endrit Shala, me të cilën do ta dëshmojnë duke ofruar argumentet për vërtetimin e rastit.

Më tutje theksohet se ka qenë një fotografi e rastit se absolutisht nuk kanë pasur për qëllim ekspozimin për çështje të fushatës zgjedhore.

Subjekti politik Nisma Socialdemokrate në përgjigjen e tijë njofton se pas pranimit të ankesës në fjalë, menjëherë ka njoftuar kandidatin për deputet z. Endrit Shala dhe kanë larguar fotografën nga faqja zyrtare në Facebook dhe janë siguruar se kjo fotografi nuk është ekspozuar NISMA-AKR-PD kërkon nga PZAP-i, që të merr në konsideratë përgjigjen e subjektit të tyre dhe të hedhe poshtë ankesën të bërë nga BIRN dhe IKS.

Përgjigjes në ankesë, subjekti në fjalë ka bashkangjitur deklaratën e bashkësisë familjare të z. Shala, printimit e postimit për të cilën është bërë ankesa, si dhe ka propozuar që të verifikohet faqja e z. Shala, i cili ka larguar lajmin në tërësi nga faqja e tijë – Endrit Shala.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se kandidati Endrit Shala, nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, ka përdorur fëmijën në një tubim për fushatë zgjedhore, fëmija ka pasur të veshur një bluzë që bën thirrje për ta votuar kandidatin nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, Endrit Shala, dhe i janë postuar në rrjetin social Facebook, nga vetë kandidati në fjalë, fakt që vërtetohet nga fotografitë e bashkangjitura ankesës, veprim ky që është në kundërshtim, nenin 2, pika 5.3 e Riformuluar pika b), c), d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019, mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së, që në rastin konkret, personat nën 18 vjet bartin material promovues gjatë fushatës zgjedhore, ku i njëjti ka veshur bluzën me emrin e kandidadtit në fjalë nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD.

Fakti që subjekti në fjalë ka bashkangjitur deklaratën e bashkësisë familjare të z. Shala, e ka marrë; parasysh paneli me rastin e vendosjes, por ky fakt nuk është arsye për të vendosur ndryshe, pasi me nenin 2, pika 5.3 e Riformuluar pika b), c), d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019, mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së, as fëmijët e familjareve nuk mund të përdoren për bartjen e materialit promovues gjatë fushatës zgjedhore.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se koalicionit NISMA-AKR-PD, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje, dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër, PZAP-i, e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin e tyre se në foton e bashkangjitur shihet djali i i knadidatit na radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, i cili ka qenë bashkë me prindin e tij, fëmija nuk ka qenë i përdorur për fushatë, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që fotografia e fëmijës është hequr nga faqja zyrtare në Facebook, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me vendosjen si në dispozitiv, paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 95/2019 më datën 27.09.2019.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.